



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.220, datë 29.06.2021

**PËR KUALIFIKIMIN E KANDIDTIT QË PLOTËSON KUSHTET PËR KANDIDIM
PËR NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË
PROKURORIVE TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 47 pika 6, nenin 52 pika 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 90 të Kodit të Procedurave Administrative, në germën “k” të nenit 4, nenin 8, nenin 9 pika 3 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm” miratuar me Vendimin nr.200, datë 23.09.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Të kualifikojë kandidatin, që plotëson kushtet për kandidim për ngritjen në detyrë në pozicionin e Drejtuesit si më poshtë:

➤ **Durim Bedini**, kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë.

2. Përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrën e drejtuesit në prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, Gjirokastrë, Berat dhe Përmet, ku nuk ka kandidatë të kualifikuar.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

**KRYETAR
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA**

**ANËTAR
KOSTAQ BELURI**

**ANËTAR
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR
MOISI DUDA**

**ANËTAR
VATË STAKA**

**ANËTAR
SANDËR BEGI**

**ANËTAR
TARTAR BAZAJ**

